



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 702/Prot.
11

Tiranë, më 29.04 2022

VENDIM QARKULLUES

Nr. 45 datë 29.04 2022

“PËR
KONFIRMIMIN E VENDIMIT TË REKTORATIT NR 29 DATË 21.04.2021
”PËR MIRATIMIN E VAZHDIMIT TË OFRIMIT TË TRAJNIMEVE PËR MODULET
E AKREDITUARA, PËR PROPOZIMIN E TARIFËS PËR KREDIT DHE
SHPËRNDARJEN E TË ARDHURAVE
NGA QENDRA E TRAJNIMIT TË VAZHDUAR”

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, Statuti i UST, propozimin e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes nr. 404 datë 08.03.2021 ”Kërkesë për miratimin e tarifës së shpërndarjes së të ardhurave për kryerjen e trajnimeve të mësuesve nga “Qendra e trajnimit të vazhduar” në FSHL, Vendimin e Rektoratit nr. 29 datë 20.04.2021 ”Për miratimin e vazhdimit të ofrimit të trajnimeve për modulet e akredituara, për propozimin e tarifës për kredit dhe të shpërndarjes së të ardhurave nga qendra e trajnimit të vazhduar”, shkresën nr. 365 datë 28.02.2022 “Përcjellje informacioni në përfundim të trajnimeve të mësuesve të zhvilluara në FSHL”, shkresën nr. 603 datë 11.04.2022 “Përcjellje informacioni lidhur me planifikimet e trajnimeve të mësuesve në FSHL”, Senati akademik me Vendim Qarkullues

V E N D O S I:

1. Miratimin e vazhdimit të ofrimit të trajnimeve për mësuesit e arsimit parauniversitar për modulet e akredituara dhe konfirmon për tarifën për kredit në vlerën prej 1200 (njemijedyqind)lekë.
2. Miratimin e propozimit për shpërndarjen e të ardhurave të krijuara nga Qendra e formimit të vazhduar” në bazë të numrit të të trajnuarve në modulin /modulet përkatëse, si më poshtë:
 - Në masën 70% për personelin akademik që merret me trajnimet.
 - Në masën 15% për mbulimin e kostove administrative.

- Në masën 15% për mbulimin e kostove të përgjithshme materiale , shërbime amortizim pajisje.
3. Kjo ndarje do të funksionojë për të gjithë procedurat që janë në proces sipas shkresave përkatëse.
 4. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit.

KRYETARI I SENATIT

Prof.Dr.AGRON KASA



Prof.Dr. ADRIATIK META

Prof.Dr. DHURATA BOZO

Prof.Dr. FATOS GJATA

Prof.Dr. DHIMITRAQ SKËNDERI

Prof.Asoc. ARBEN KAÇURRI

Prof.Asoc. ROBERT ÇITOZI

Prof.Asoc. JUEL JARANI

Prof.Asoc. BASHKIM DELIA

Dr. ELTON SPAHIU

XHEMAL ÇULLHAJ